



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni pranveror

Komisioni i Shëndetësisë, Punës dhe Mirëqenies Sociale

Mbledhja nr. 36

Prishtinë, më 28 mars 2012, në orën 11: 00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-10

P R O C E S V E R B A L
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR SHËNDETËSI, PUNË
DHE MIRËQENIE SOCIALE

Në mbledhje morën pjesë: Fikrim Damka, Nazane Breca, Time Kadrijaj, Gëzim Kelmendi, Sasha Gjokiq, Bahri Thaçi dhe Liburn Aliu.

Munguan: Flora Brovina, Salihe Mustafa.

Të pranishëm: Aurora Bakalli-deputete; Shpresa Haxhijaj- administratore e Komisionit; Enis Halimi – zyrtar i fushës për shëndetësi; Florie Kryeziu- UNICEF.

Mbledhjen e kryesoi, Fikrim Damka- kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Takim me ministrin e Shëndetësisë, z. Ferid Agani;**
- 3. Të ndryshme.**

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1.Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Takim me ministrin e Shëndetësisë, z. Ferid Agani

Fikrim Damka- Tha se sot e kemi ftuar ministrin e Shëndetësisë për të diskutuar për gjendjen në shëndetësi, sidomos për dy ligje kryesore, Ligjin për shëndetësinë dhe Ligjin për sigurime shëndetësore.

Ferid Agani- I njoftoi anëtarët e Komisionit se ligjet në fjalë janë dorëzuar në Qeveri në qershor të vitit 2011. Negociatat me FMN-në dhe BB-në kanë vazhduar nga gushti i vitit të kaluar. Me këtë rast, BB-ja jep një vlerësim pozitiv për këto ligje. Hezitim për këto dy ligje ka pasur nga FMN-ja. Në dhjetor të vitit të kaluar, kemi pasur takime me FMN-në, pas të cilit ka pasur një raport pozitiv për to. Sipas këtij raporti, janë dy ligje më të mirat në rajon. Pas kësaj, pati një heshtje nga FMN-ja, përkundër insistimit tim që ky proces të vazhdohet. Të dy ligjet kanë një kosto rreth 10 milionë euro. Në mars kemi pasur takim me FMN-në përsëri. Në këtë takim u konkludua se të dy ligjet gëzojnë përkrahjen e plotë. U kërkua që implementimi i këtyre ligjeve të bëhet në etapa, pra të fillohet me Ligjin për shëndetësinë, derisa të ndërtohen kapacitetet e nevojshme për fillimin e sistemit të sigurimeve shëndetësore. Ata insistonin që të mos përmendim data se kur mund të fillohet me implementimin e këtyre ligjeve. U kam thënë se unë nuk jam në gjendje ta marr përgjegjësinë për të filluar zbatimin e njërit ligj pa ligjin tjetër. Në Letrën e qëllimit, për herë të parë përmendet Fondi i Sigurimeve Shëndetësore. Frika e FMN-së është se Fondi i sigurimeve do të ballafaqohet me kërkesa të shumta, të cilat nuk do të mund t'i përmbushë dhe kështu do të ndodhej në deficit. Është me rëndësi që përmbajtja e ligjeve nuk kontestohet.

Brenda 2 javësh do të miratohet në Qeveri Ligji për shëndetësinë.

Time Kadriaj- Deklaroi se është i kuptueshëm hezitimi për Ligjin për sigurimet shëndetësore, por shtyrja e Ligjit për shëndetësi nuk është e arsyeshme, kur e dimë se ligji ekziston dhe zbatohet, ndërkaq tash po bëhet vetëm plotësim-ndryshimi i tij. Pra, përsëri këto dy ligje po vijnë si të veçanta.

Nazane Breca- Shprehu falënderimin për ministrin. BB-ja para një kohe, e ka pasur një projekt për pakon bazike të shërbimeve shëndetësore. A do ta përdorni atë pako apo do të bëhet një pako e re e shërbimeve? Ne kemi qenë në Turqi dhe e kemi parë sesi funksionon sistemi atje.

Ferid Agani- Duke u përgjigjur, tha se ky Ligj është i ri dhe nuk është plotësim-ndryshim. Në Turqi, sistemi funksionon me partneritet publiko-privat. Pakoja themelore do të përpilohet me konsulencë me ish-ministrin e Shëndetësisë së Sllovenisë. Çdo shërbim që ofrohet, të jetë pjesë e pakos. Duhet të limitohet nevoja për shërim jashtë vendit.

Liburn Aliu- Pyeti: Kur pritet të vijë Ligji për sigurime shëndetësore?

Ferid Agani- U përgjigj se beson se deri në shtator do ta kemi të miratuar Ligjin për sigurime shëndetësore. Por, megjithatë, bazuar në përvojën që kemi me FMN-në, nuk mund të garantoj me siguri lidhur me këtë.

Liburn Aliu- Nëse këto dy ligje shkojnë në pako, atëherë ne mund ta shtyjmë për pak kohë Ligjin për shëndetësi, në mënyrë që t'i miratojmë pothuajse së bashku këto dy ligje. Në Turqi kemi parë një sistem publik shëndetësor shumë të fortë. Kjo më duket në kundërshtim me konceptin e partneritetit publiko - privat në këtë fazë.

Ferid Agani- Unë nuk kam inkurajuar ndërtimin e kapaciteteve private shëndetësore nga investitorët e huaj. Ne duhet ta forcojmë sistemin publik shëndetësor. Kjo bëhet me partneritet publiko - privat. Kjo mund të bëhet duke blerë shërbime nga privatët dhe duke ndërtuar qendra të mëdha me koncesione publiko - private. Neve na duhet një partneritet publiko - privat afatshkurtër, duke blerë shërbime nga privatët. Sistemi turk është i centralizuar.

Aurora Bakalli- Deklaroi se këto dy ligje nuk mund të shkojnë si të ndara. Si ka mundësi të realizohet kjo në etapa? Si mendoni që do ta zvogëloni numrin e pacientëve që kërkojnë shërim jashtë vendit? Partneritetin publiko - privat e shoh si të mirë, por duke qenë i projektuar me kujdes.

Bahri Thaçi- Duke shpjeguar për preventivën, tha se shëndetësia kosovare në aspektin e preventivës është shumë e suksesshme. Ne kemi rezultate të mira, krahasuar me rajonin. Me sa kuptova, FMN-ja insiston që ta shohë zbatimin e Ligjit për shëndetësi, e tek më pastaj ta japë sinjalin për fillimin e zbatimit të Ligjit për sigurime shëndetësore. Besoj që edhe ata e dinë se Zbatimi i Ligjit për shëndetësinë nuk do të mund të jepte rezultate të mira pa Ligjin për sigurime shëndetësore. Mos po i eksponohemi rrezikut për t'u treguar të pasuksesshëm, nëse fillojmë zbatimin e vetëm njërit ligj?

Nazane Breca- Tha se në Turqi ka një ndarje të punëtorëve në mes të sektorit publik dhe privat. Mendoj se edhe te ne duhet të bëhet një ndarje e tillë dhe duhet të paguhet punëtori shëndetësor në bazë të performancës.

Ferid Agani- Duke u përgjigjur në çështjet e ngritura, tha se ne nuk kemi rrugë tjetër, përpos që t'i miratojmë këto ligje në partneritet me FMN-në. Ne duhet ta vazhdojmë procesin e dialogut me ta. Shërbimi Kombëtar i Shëndetësisë duhet të themelohet, sepse Ministria nuk mund të blejë shërbime nëse ende i ka spitalet nën menaxhim të vetin.

Liburn Aliu- Tha se ideja e Shërbimit Kombëtar të Shëndetësisë dhe agjencive të tjera është improvizim dhe është pasojë e decentralizimit.

Aurora Bakalli- Tha se sektori publik shëndetësor nuk mund të jetë fitimprurës. Duhet investuar në sistemin publik shëndetësor. Shërbimi Kombëtar Shëndetësor nuk do të jetë efikas.

Ferid Agani- Deklaroi se fjala improvizim është e rëndë. Shëndetësia është specifike. Modeli i Shërbimit Kombëtar është model që aplikohet në Itali dhe Britani, por ky do të jetë model i yni. Sektori privat është shumë i dobët në Kosovë. Shëndetësinë duhet ta depolitizojmë.

Nazane Breca- E pyeti ministrin: Si do të zgjidhen anëtarët e bordit të Shërbimit Kombëtar Shëndetësor?

Ferid Agani- Duke u përgjigjur, tha se ka rrezik të politizimit të bordit të Shërbimit Kombëtar të Shëndetësisë. Ka pasur kërkesa që Shërbimi të themelohet nga Kuvendi, por nuk mund të garantojmë se kjo e ruan pavarësinë e këtij organi.

Bahri Thaçi- Deklaroi se ky Komision i përkrah këto ligje. Mendoj se jemi në një vëzhgim nga FMN-ja dhe nëse japim dëshmi të zotësisë sonë, do të marrim sinjale pozitive nga ta.

Time Kadriaj- I informoi të pranishmit se ka marrë një kërkesë nga disa mjekë onkologë lidhur me punësimin e tyre. Punësimi i tyre duhet të jetë prioritet.

Ferid Agani- Duke u përgjigjur, tha se këta mjekë i kemi mbështetur shumë gjatë specializimit të tyre. Ne tash do të shpallim konkurs për 60 specialistë dhe do të bëhet edhe një zgjidhje për onkologët. Do të punësohen 4 onkologë. Më vonë, me privatizimin e kuzhinës së QKUK-së, ne do të punësojmë edhe më shumë specialistë.

Liburn Aliu- Deklaroi se Udhëzimin administrativ 01/2012, nuk kemi mundur ta sigurojmë. Përse nuk e keni shpallur në ueb faqen e Ministrisë? Ky udhëzim nuk është në përputhje me ligjin. Titulli i udhëzimit ka të bëjë me licencimin e përkohshëm, që, si i tillë, nuk ekziston askund në ligj. Kriteret për këtë licencim janë shumë të buta dhe të thjeshta. Jam dakord të vijmë mjekët që janë deficit te ne, por kriteret duhet të jenë më të forta. Është shumë e shkurtër koha prej 8 ditëve për këtë licencim.

Ferid Agani- Duke u përgjigjur, tha se ky udhëzim është në fuqi nga viti 2006. Ky që e kemi nxjerrë tash, është me vetëm disa ndryshime të vogla, siç është zgjatja e afatit për të drejtën e punës së punëtorëve të huaj shëndetësorë. Pajtohem se duhet të ketë një rigoroze më të madh të kriterëve.

Time Kadriaj- Deklaroi se licencimi i institucioneve private shëndetësore ka filluar më 2006. Ky udhëzim ka mundësuar që të vihet situata në kontroll.

Aurora Bakalli- Tha se te ne, po vijmë njerëz me kualitet të dyshimtë. Konkretisht, djali i Borqe Petrovskit, në spitalin EDA. Ka raste kur pacientët na vijmë në QKUK pa faksimile të mjekut, i cili e ka bërë ndërhyrjen.

Ferid Agani- Deklaroi se do të merren masat e duhura në këtë drejtim. Ne duhet të futemi në konkurrencë të hapur dhe me këtë ta rrisim kualitetin e punës.

Liburn Aliu- Kur flasim për konkurrencën dhe hapjen, potenciali ynë do të shkatërrohet dhe ne nuk do të zhvillohemi. Këto gjëra duhet të bëhen me plan, duke i zhvilluar kapacitetet tona. Cilësia ngritët me kriterë. Si mundet që për 8 ditë të licencohet një profesionist shëndetësor?

Gëzim Kelmendi- Tha se ne të gjithë kemi qenë unikë që të angazhohemi për shëndetin e pacientit, pa asnjë dallim partiak. U dakorduar që të diskutojmë me ministrin rreth udhëzimit, ndërsa ti, Liburn, e shfrytëzove për qëllime politike, duke dalë në konferencë për shtyp për ta kritikuar këtë udhëzim, ndonëse ende nuk e dinim përmbajtjen e tij. Kjo nuk është korrekte. Profesionisti shëndetësor i kryen procedurat e licencimit në vendin e tij dhe 8 ditë janë të mjaftueshme.

Liburn Aliu- Deklaroi se ne nuk kemi mundur ta sigurojmë udhëzimin. Ky nuk ka qenë publik. Përmbajtja e tij është skandalozë dhe pikërisht për këtë kam dalë publikisht në konferencë. Duhet të kemi marrëveshje me shtetet e tjera për njohjen reciproke të diplomave dhe licencave. Për 8 ditë nuk mund të licencohet një mjek nga një shtet, me të cilin nuk kemi marrëveshje.

Ferid Agani- Ne duhet ta rrisim cilësinë me konkurrencë dhe jo me izolim. Ky udhëzim, që nga 2006 ka mundësuar që të kemi shërbime shëndetësore, të cilat nuk i kemi në QKUK. Nuk bën të pengohet puna e profesionistëve të jashtëm në vendin tonë. Mund të bëhet një verifikim më i mirë i këtyre profesionistëve.

Liburn Aliu- Tha se për shërbimet që nuk i ofrojmë ne, mund të marrim profesionistë nga jashtë. Unë nuk jam për izolim. Mjekët tanë nuk mund të përfitojnë nga profesionistët nga jashtë, sepse ata punojnë vetëm në institucionet private shëndetësore. Ne nuk i dërgojmë në mënyrë të organizuar specializantët, në mënyrë që ata të aftësohen duke e parë profesionistin nga jashtë duke punuar.

Ferid Agani- Tha se mjekët e huaj në spitalet private janë në pakicë absolute.

Time Kadriaj- Nuk është e zakonshme që institucionet private të marrin mjekë të palicencuar, të cilët nuk kanë cilësi, sepse kjo nuk i shkon përshtati institucionit.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Fikrim Damka